

Departamenti i Prokurimit

Prishtina: datë, 07.10.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.10.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Quality Asphalt”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërimi i rrugës Vidime-Lumi i Marecit -faza II**”, me Nr. të Prok: **616 21 095 511** nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Quality Asphalt” të dt. 05.10.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërimi i rrugës Vidime-Lumi i Marecit -faza II**”, me Nr. **616 21 095 511**, kundër Vendimi për dhenie, të datës 30.09.2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. *Anullohet* vendimi i AK për *dhënien e kontratës* për lotin II të këtij aktiviteti i publikuar me datë: 30.09.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kthej aktiivtetin, respektivisht lotin II te aktivitetit në rivlerësim* ;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën me datën 07.10.2021 dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se është shkelja e nenit 1 të LPP-së nuk qëndron pasi që komisioni ka rekomanduar në bazë të vlerësimit të vet se tenderi juaj është i pa përgjegjshëm,por ndoshta lëshimi i komisionit qëndron në faktin se është dashtë të analizoj saktë se a ka bazë për kërkim të sqarimeve shtesë lidhur me numrin e punëtorëve,pasi që në ofertën e dorëzuar keni dorëzuar listën vetëm nga njeri anëtar i grupit dhe atë me numër më të vogël se sa që është kërkuar në FDT;

-Por pasi që ka konstatuar se duhet kërkuar sqarimet shtesë është dashtë që të njejtat ti trajtoj sipas kërkesave nga FDT,sipas të cilave nuk është kërkuar ndonjë dëshmi konkrete përpos deklarimit të tenderuesëve;


-Lidhur me pretendimin se është shkelur neni 7 i LPP pjesërisht keni të drejt,pasi që pas sqarimeve të pranuar pa marrë parasysh arsyeshmerinë e kërkesës për sqarime është dashtë që sqarimet të trajtohen sipas kërkesave të FDT-së

Bazuar në këto konstatime kam vendosur që aktiviteti për lotin 2 të kthehet në rivlerësim dhe në atë fazë një komision profesional të trajtoj drejt arsyeshmërinë e kërkesës për sqarime dhe sqarimet e dorëzuara nga pretenduesi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit